



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.112/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kandidatës së tyre në afërsi të objekteve publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.112/2019 e datës 27.09.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 27.09.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019 në orën 13:30, në komunën e Pejës, perballë Gjykatës themelore në Pejë, jo me larg se 40 metra nga hyrja e gjykatës së Pejës, shihet posterit i kandidatës për deputete i këtij subjekti Suzana Muriqi, ku në të njëjtin objekt ku janë vendosur posteret gjendet edhe Qendra për pune Sociale. Me këtë rast paraqitesi i ankesës thekson se vendosja e posterave në afërsi të institucioneve publike është në kundërshtim me rregullen zgjedhore Nr.13/2013, “Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike”, përkatësisht nenin 3 pika 3.4. Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.09.2019, subjekti politik LDK, thekson se ankesa e paraqitur nga organizata BIRN dhe IKS me Anr.112/2019, me date 27.09.2019 është e pabazë, sepse në kushte dhe rrethana në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, siç pretendon pala ankuese se është vendosur 40 metra larg Gjykatës Themelore Pejë, dhe se dispozitat ligjore të LKP-së, gjegjësisht neni 33 pika b) nuk e specifikon largësinë apo afërsinë e vendosjes në rastin konkret të posterit, e as dispozitat e Rregullave 11/2013, dhe Rregullës 13/2013 nuk janë aq strikte sa për të përcaktuar shkelje vendosjen e materialeve zgjedhore edhe në afërsi të objekteve. Me tutje subjekti politik LDK, në përgjigje thekson se vendi se ku është vendosur posterit në fjalë është objekt (billboard) që i takon apo e ka në posedim kompania private, për të cilën hapësire ajo paguan qira të shfrytëzimit (posedimit faktik).

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posteri lëndor i kandidatit nga subjekti politik LDK, është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posterat janë vendosur 40 metra nga hyrja e Gjykatës së Pejës, vlerëson se në këtë periudhe kohore këto veprime nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, nëse objekti në të cilën pretendohet se është i vendosur posteri 40 metra në hyrje shërben si Qendër e Votimit, sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet, se: *"Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji"*

Periudha kohore për të cilën parashihet të aplikohet dispozita e lart cituar ligjore është 24 orë para procesit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti në të cilën pretendohet se është vendosur posteri afër tij shfrytëzohet si qendër e votimit në ditën e votimit, andaj paneli erdhi në përfundim se pretendimet e paraqitësit të ankesës, janë të paqëndrueshme dhe bazuar në arsyet e theksuar më lartë, dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.112/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haxhiu



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.